

Nr. Prot.: 06/22

Datë: 22.08.2022

Bazuar në Ligjin Nr.02/L-42 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2013, Rregulloren e Brendshme për Regjistrimin e Nxënësve, Vendimin e Akreditimit nga Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve Nr. 01/400, të datës 20.08.2021 si dhe bazuar në Vendimin e Komisionit për Licencim të MASHTI-t Ref.nr: 3/1763, të datës 14.10.2021, Shkolla e Mesme e Mjekësisë në kuadër të Kolegjit ISPE shpall:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLËN E MESME TË MJEKËSISË NË KUADËR TË KOLEGJI ISPE PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023

1. Për pranimin e nxënësve të rinjë në Shkollën e Mesme të Mjekësisë, për vitin shkollor 2022/2023;
2. Konkursi shpallet për Kualifikimet e Validuara dhe Akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve si dhe të Licencuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit:
 - **Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë;**
 - **Teknik Dentar.**
3. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve:
 - Të drejtën e regjistrimit e kanë të gjithë kandidatët të cilët e kanë të përfunduar me sukses shkollimin e mesëm të ulët dhe të cilët e kanë të përfunduar me sukses testin e arritshmërisë;

- Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
4. Dokumentet e nevojshme për konkurrim:
- Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të, duhet të paraqesin këto dokumente:
 - ✓ Fletëparaqitjen (e cila merret në Kolegjin ISPE);
 - ✓ Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9);
 - ✓ Certifikatën e lindjes dhe
 - ✓ Dy fotografi
5. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve:
- Paraqitja e dokumenteve për vitin shkollor 2022/23, bëhet nga data **25/08/2022** deri më datë **26/08/2022**.
 - Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen me datën **29/08/2022**.
 - Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës **29/08/2022**.
 - Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHTI - komisionit për ankesa.
6. Kriteret për regjistrim:
- Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë kriteret sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013.

Drejtoresha:
Kumrije Sahiti



Prishtinë, 22 Gusht 2022